

Propozimet nga Dega e Tearcës për programin zgjedhor,
për zgjedhjet komunale 2021

1. QENDRA RINORE KOMUNALE – TEARCË

Hapja e qendrës rinore në kuadër të komunës me hapësirë për kurse të IT dhe gjuhëve të huaja, bibliotekë për të rinjtë, hapësirë për aktivitete kulturore, hapësirë për aktivitete sportive etj.

2. ZYRA PËR PARTNERITET EKONOMIK

Zhvillimi ekonomik do të jetë prioritet kryesor i komunës, andaj në kuadër të komunës do të hapet zyrë për partneritet ekonomik. Zyra do të ketë sektor të veçantë për partneritet ekonomik me Diasporën, sektor të veçantë për partneritet ekonomik me investitorët nga Zvicra, qendër për përpilimin e projekteve të reja, qendra për start-up biznese dhe do të ofrojë programe trajnimi dhe mbështetje falas për shërbime administrative.

3. MJEKËSIA URGJENTE

Do të bëjmë hapjen e një qendre për mjekësi urgjente, me vetura të ambulancës me shërbim 24/7

4. THEMELIMI I NJËSISË SË ZJARRFIKËSVE

Në kuadër të komunës do të themelojmë njësi për zjarrfikës me shërbim 24/7. Do të ndërtohet objekti i zjarrfikësve dhe ai do të pajiset me të gjitha mjetet e nevojshme.

5. NDËRMARRJA PUBLIKE KOMUNALE (NPK)

Planifikohet rritja e ingerencave të ndërmarrjes publike ekzistuese. Rritja e kapaciteteve të NPK-së me resurse të reja njerëzore (15-20 persona), infrastrukturë të mirëfilltë dhe pajisjen me mjete të nevojshme.

Në kuadër të NPK-së do të hapet qendër për grumbullimin dhe reciklimin e pajisjeve të vjetra shtëpiake.

Planifikohet kalimi i tenderit për grumbullimin e mbeturinave nga sektori privat në ingerencat e NPK-së.

NPK do administrojë me pastrimin dhe mirëmbajtjen sistematike të rrugëve, kanaleve si dhe mirëmbajtjen e ambientit dhe krijimin e hapësirave të reja me gjelbërim dhe parqeve.

NPK do bëjë largimin e deponive të egra.

NPK do të bëjë vendosjen e kontejnerëve multifunksional (të destinuara për riciklim).

Hapja e Qendrës për Përkujdesje të qenve endacakë si dhe menaxhimi saj nga ana e NPK-së.

6. UJËSJELLËSI - SISTEMI I UJIT TË PIJSHËM

Akumulimi i burimeve të ujit të pijshëm dhe ndërtimi i rezervuarit për ujë të pijshëm për fshatrat Tearcë, Përshëfcë dhe Glogjë.

Riparimi i gypave të ujësjellësit në fshatin Neproshten

Ndërtimi i rrjetit sekundar të ujësjellësit si dhe ndërtimi i stacionit të filtrimit dhe akumulimit të ujit prej lumit të fshatit Sllatinë

Instalimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Dobrosht

7. RENOVIMI I SHKOLLAVE FILLORE, FUSHA TË REJA SPORTI

Renovimi i shkollës filllore dhe ndërtimi i murit rrethues në Neproshten.
Renovimi i shkollës filllore (dritaret) në Odër.
Renovimi i shkollës filllore në Nerasht.
Ndërtimi i sallës për sport në Tearcë.
Ndërtimi i fushës së futbollit në Nerasht dhe Dobrosht.

8. ÇERDHE, BIBLIOTEKA, KËNDE LOJËRASH PËR FËMIJË

Ndërtimi i çerdheve, bibliotekave dhe këndeve të lojërave për fëmijë në çdo vendbanim, pranë shkollës filllore

9. RRJET KANALIZIMI NË GJITHË KOMUNËN

Rishqyrtimi i projektit ekzistues për kanalizim në fshatin Tearcë me mundësi korigjimi dhe përfshirja e të gjitha vendbanimeve në projektin për kanalizim

10. LUMENJTË, RRUGËT DHE SISTEMI I UJITJES PËR BUJQËSI

Rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe ndërtimi i rrjetit për ujitje të tokave bujqësore.
Rregullimi i infrastrukturës rrugore dhe qasja e lirë deri tek tokat bujqësore

11. PLAN I RI URBANISTIK

Planifikohet përgatitja e një plani të ri gjeneral urbanistik si dhe krijimi i një plani detal për çdo vendbanim. Rregullimi i çështjeve pronësore – juridike të shkollave filllore në nivel komunal

12. ADMINISTRATA KOMUNALE, TRANSPARENCA, EFIKASITETI DHE DIGJITALIZIMI

Transformim i mirëfilltë i administratës aktuale në një administratë profesionale, efikase dhe të përgjegjshme.

Zyra për auditim të brendshëm.

Transparencë e plotë e shpenzimeve dhe të gjitha dokumenteve me karakter publik.

Digjitalizim i administratës komunale.

Aplikacion i veçantë për komunikim direkt të qytetarëve me kryetarin e komunës.